Reclassified as Public pursuant to instructions contained in CRSPD390 of 12 December 2023
PUBLIC ~~CONFIDENTIAL~~
Date original: 08/08/2023 14:56:00
Date translation: 17/02/2025 10:12:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** **KSC-BC-2020-06**

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** **Trupi Gjykues II**

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 8 gusht 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** **Konfidencial**

---

**Vendimi i Katërt mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore**

---

**Ushtruesit të Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar**
Vard Ferdinandse

**Mbrojtësit të Viktimave**
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**
Venkatesvari Alagendra

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (″Rregullorja″), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues ftoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") të paraqiste mocion për pranim të provave jogojore në lidhje me: (i) provat materiale të propozuara të identifikuara në listën e saj të provave materiale që synon t′i përdorë për cilindo nga 40 dëshmitarët e parë të saj; dhe (ii) materialin provues që ZPS-ja e gjykon të rëndësishëm për paraqitjen e qartë dhe efektive të provave të saj në këtë fazë ("urdhri i katërt gojor").[1]

2. Më 8 shkurt 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar paraqiti kërkesë për pranimin e provave jogojore ("Mocioni i Provave Jogojore").[2]

3. Më 21 shkurt 2023, me kërkesë të Mbrojtjeve të Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi′) dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") ("të akuzuarit" dhe "Mbrojtja"), Trupi Gjykues e zgjati afatin për përgjigje ndaj Mocionit të Provave Jogojore deri më 21 mars 2023.[3]

4. Më 21 mars 2023, Mbrojtja u përgjigj ndaj Mocionit të Provave Jogojore ("Përgjigjja").[4]

---

[1] Transkripti i seancës, Trupi Gjykues, 16 dhjetor 2022, f. 1775, rreshti 6 to f. 1776, rreshti 5.
[2] F01268, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 8 shkurt 2023, me Shtojcat 1-4, 6, 7, konfidenciale, dhe me Shtojcat 5, 8.
[3] F01309, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mocion të Rishikuar për Provat Jogojore dhe Pezullim e Zgjatje Afati*, 21 shkurt 2023, para. 15, 16(c).
[4] F01387, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-8, konfidenciale.

5. Më 31 mars, 9 qershor dhe 27 korrik 2023, Trupi Gjykues lëshoi vendime në të cilat trajtoi pjesërisht Mocionin e Provave Jogojore ("Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore", "Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore" dhe "Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Provave Jogojore").[5]

## II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon pranimin si prova jogojore të materialeve të ndara në gjashtë kategori: (i) komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm ("SHP") të Ushtrisë Çlirimtar të Kosovës ("UÇK"), deklaratat politike dhe njoftimet e tjera; (ii) versionet e punës së deklaratave publike të UÇK-së, që iu sekuestruan z. Krasniqi; (iii) arkivat e publikuara të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, "Radio Kosova e Lirë" ("RKL"); (iv) arkivat e publikuara të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, "Kosovapress"; (v) ribotimet e materialit të agjencisë së lajmeve *Kosovapress* në media të tjera; dhe (vi) materialet e tjera që nuk mund të klasifikohen në kategori konkrete por përfshihen në kuadrin e urdhrit të katërt gojor të Trupit Gjykues.[6]

7. Mbrojtja përgjigjet se Mocioni i Provave Jogojore është përpjekje e paarsyeshme dhe dëmtuese për të pranuar një vëllim të madh të provave duke anashkaluar shqyrtimin e drejtë dhe vlerësimin e autenticitetit të dokumenteve dhe verifikimin e tyre duke i paraqitur përmes dëshmitarëve përkatës.[7] Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk ka respektuar vendimin e Trupit Gjykues për kritere të rrepta të vlerësimit për të mundësuar paraqitjen e provave me vlerë të lartë.[8]

---

[5] F01409, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 31 mars 2023, konfidencial; F01596, Trupi Gjykues, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 9 qershor 2023, konfidencial dhe *ex parte* (riklasifikuar si konfidencial më 22 qershor 2023); F01705, Trupi Gjykues, *Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 27 korrik 2023, konfidencial.
[6] Mocioni i Provave Jogojore, para. 2.
[7] Përgjigjja, para. 1.
[8] Përgjigjja, para. 3.

PUBLIC ~~CONFIDENTIAL~~
Date original: 08/08/2023 14:56:00
Date translation: 17/02/2025 10:12:00

Mbrojtja shton se kjo qasje do të krijojë dokumentacion gjyqësor të fryrë dhe do të dëmtojë drejtësinë e procesit duke devijuar ndjeshëm nga parimi udhërrëfyes i paraqitjes së dëshmive gojore, të seancave publike dhe ballafaqimit, që, as nuk do ta përshpejtojë, as nuk do ta ndihmojë gjykimin e drejtë të çështjes.[9] Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton pranimin si prova jogojore të trembëdhjetë (13) kategorive të ndryshme të provave dokumentare dhe kundërshton konkretisht një numër të materialeve të tjera.[10]

## III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me pikat aktuale janë përcaktuar, në veçanti, në nenin 40(6)(h) dhe rregullën 138(1), dhe janë shtjelluar gjerësisht në Vendimin mbi Mocionin e Provave Jogojore.[11] Trupi Gjykues do të zbatojë këto standarde në këtë vendim.

---

[9] Përgjigjja. para. 4.

[10] Përgjigjja, para. 14-105; *Shih në përgjithësi*, F01387/A01, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 1 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A02, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 2 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A03, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 3 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 3 e Përgjigjes"), 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A04, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 4 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 4 e Përgjigjes"), 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A05, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 5 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 5 e Përgjigjes"), 21 mars 2023, konfidenciale; F01387/A06, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 6 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale.

[11] *Shih* Vendimin mbi Mocionit e Provave Jogojore, para. 8-13.

## IV. DISKUTIM

### A. ASPEKTE PARAPRAKE

9. Trupi Gjykues vë në dukje se, në Vendimin mbi Mocionin e Provave Jogojore, Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore dhe Vendimin e Tretë mbi Mocionin e Provave Jogojore, u dha prioritet atyre materialeve që ZPS-ja i ka identifikuar se kanë lidhje me gjashtë dëshmitarët e parë,[12] gjashtë dëshmitarët pas tyre[13] dhe materialet që përmban Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore.[14] Ky vendim plotëson ato vendime duke trajtuar konkretisht materialet që përmbajnë Shtojca 3,[15] Shtojca 4[16] dhe Shtojca 5[17] e Mocionit të Provave Jogojore.

10. Trupi Gjykues vë në dukje më tutje se tashmë ka pranuar një material që përmban Shtojca 3[18] dhe pesë materiale që përmban Shtojca 4[19] e Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore të Trupit Gjykues.[20] Rrjedhimisht, shqyrtimi i këtyre materialeve është i tejkaluar. Në Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, Trupi Gjykues gjithashtu shtyu shqyrtimin e dy materialeve,[21] që do të jetë në kontekst të këtij vendimi.

---

[12] Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore.
[13] Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore.
[14] Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Provave Jogojore.
[15] F01268/03, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 3 e Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 8 shkurt 2023, konfidenciale.
[16] F01268/04, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 4 e Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 4 e Mocionit të Provave Jogojore"), 8 shkurt 2023, konfidenciale.
[17] F01268/05, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 5 e Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Shtojca 5 e Mocionit të Provave Jogojore"), 8 shkurt 2023.
[18] 007948-007949-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1T.
[19] SPOE00054318-SPOE00054320-ET, SPOE00054513-SPOE00054514-ET, SPOE00054519-SPOE00054522-ET, SPOE00054878-SPOE00054879-ET, SPOE00054898-SPOE00054902-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2H, 2M, 2O, 3G, 3I.
[20] Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 180(b).
[21] Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 180(e); SPOE00053729-SPOE00053730-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1A2; SPOE00053796-SPOE00053797-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1I2.

11. Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja kërkon pranimin e dokumenteve në tërësi në gjuhën shqipe dhe ofron vetëm përkthime të pjesshme në anglishte.[22] Për këtë vendim, Trupi Gjykues ka vlerësuar pranueshmërinë vetëm të pjesëve të këtyre dokumenteve që janë në anglishte. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues hedh poshtë pranimin e 007789-008966, SPOE00053504-00054088, SPOE00054089-00054655, SPOE00054656-00055197 dhe SPOE00055198-00055677 në tërësi, siç janë paraqitur. Një përjashtim ndaj këtij vendimi janë fotografitë që gjenden në faqet 008172-008185 të 007789-008966, që do të trajtohen ndaras më poshtë.

## B. Provat e propozuara

### 1. Shtojcat 3 dhe 4 – Materialet e publikuara të agjencive të pretenduara të lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm. RKL dhe Kosovapress.

12. ZPS-ja parashtron se materialet që përmban Shtojca 3 janë transmetime në radio fillimisht të lëshuara nga RKL-ja midis datave 4 janar 1999 dhe 21 qershor 1999, që janë mbledhur dhe ruajtur të shtypura.[23] Shtojca 3 gjithashtu përmban një provë materiale të propozuar të përbërë nga një seri fotografish, që do të trajtohen ndaras më poshtë.[24] Sipas ZPS-së, Shtojca 4 përmban arkivat publike të agjencisë së lajmeve *Kosovapress*, të përpiluara në një libër prej katër vëllimesh me titull "Agjencia Informative Shtetërore Kosovapress: Arkivat e Luftës".[25] ZPS-ja pretendon më tej se këto materiale janë të pranueshme sepse RKL-ja dhe Kosovapress ishin agjenci të lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm, dhe rrjedhimisht deklaratat dhe opinionet e transmetuara ose të publikuara aty i përkisnin UÇK-së

[22] 007789-008966, SPOE00053504-00054088, SPOE00054089-00054655, SPOE00054656-00055197 dhe SPOE00055198-00055677; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1 dhe Shtojca 4 e Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 2, 3, 4.
[23] Mocioni i Provave Jogojore, para 20.
[24] 008172-008185-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1H2.
[25] Mocioni i Provave Jogojore, para. 25.

gjatë periudhës që mbulon Aktakuza.[26] ZPS-ja parashtron se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se Mbrojtjes nuk i shkaktohet asnjë dëm nga pranimi i tyre.[27]

13. Mbrojtja përgjigjet se Shtojcat 3 dhe 4 gjithsesi përmbajnë dëshmi të dorës së dytë, pranimi i të cilave do të ishte padrejtësisht dëmtues për Mbrojtjen sepse ajo nuk do të jetë në gjendje të kundërshtojë rrethanat në të cilat u bënë deklaratat ose të hedhë dyshime mbi besueshmërinë e tyre.[28] Mbrojtja gjithashtu pretendon se këto dokumente nuk përmbajnë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit[29] dhe nuk provojnë ose hedhin poshtë ndonjë pikë relevante për çështjen, dhe për rrjedhojë nuk kanë vlerë provuese.[30] Së fundi, Mbrojtja pretendon se përmbajtja e deklaratave që përmbajnë Shtojcat 3 dhe 4 nuk janë të besueshme sepse këto deklarata jashtëgjyqësore nuk u dhanë për t'u përdorur në proces gjyqësor; përkundrazi, qëllimi i tyre mund të ketë qenë për të ngritur moralin, fituar përkrahjen ndërkombëtare, qetësuar popullatën civile, apo për të promovuar veten.[31]

14. Për pranimin e provave materiale të propozuara kërkohet demonstrimi i autenticitetit *prima facie* dhe vlerës provuese. Sa u përket raporteve të shtypit, artikujve dhe intervistave në gazeta të ofruara si prova jogojore, për të demonstruar këtë standard në përgjithësi kërkohet që materiali të ketë datën e artikullit, emrin e gazetës, dhe/ose emrin e autorit (nëse artikulli ose deklarata për shtyp ka autor) për të përcaktuar tregues të mjaftueshëm të besueshmërisë dhe të autenticitetit.[32] Këta tregues gjithashtu mund të jenë të qartë nga elemente të tjera,

---

[26] Mocioni i Provave Jogojore, para. 23.
[27] Mocioni i Provave Jogojore, para. 3, 21-23.
[28] Përgjigjja, para. 59.
[29] Shtojca 3 e Përgjigjes, materiali 1; Shtojca 4 e Përgjigjes, materiali 1.
[30] Shtojca 3 e Përgjigjes, materiali 1; Shtojca 4 e Përgjigjes, materiali 1.
[31] Përgjigjja, para. 60.
[32] KSC-BC-2020-07, F00334, Trupi Gjykues II, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 31-35, 39-41; International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia

përfshirë përmbajtjen e dokumentit. Fakti që prokuroria nuk është në gjendje të identifikojë autorët e këtyre raporteve nuk e bën materialin në vetvete të papranueshëm.[33]

15. Shtojca 3 përmban 77 pjesë në anglishte që burojnë nga libri me tri vëllime, Arkivat e RKL-së që kryesisht përmbajnë transkripte të transmetimeve të RKL-së midis datave 4 janar dhe 21 qershor 1999.[34]

16. Shtojca 4 përmban 140 pjesë në anglishte që burojnë nga libri me katër vëllime i arkivave të luftës të agjencisë së lajmeve Kosovapress që kryesisht përmbajnë artikuj të botuar në Kosovapress midis datave 4 janar dhe 28 shkurt 1999.[35]

17. Materiali i përfshirë në këto pjesë përmban: (i) parathënie dhe komente;[36] (ii) komunikata të Shtabit të Përgjithshëm;[37] dhe dekrete politike të Shtabit të

---

("ICTY") (Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ")), *Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, *Decision on Defence's Fifth Motion for the Admission of Documents from the Bar Table*, 30 May 2016, para. 13-15; *Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, *Decision on Prosecution Motion for Admission of Documents from the Bar Table (Military and Residual Documents)*, 13 February 2014, para. 16.

[33] International Criminal Court ("ICC"), *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo*, ICC-01/05-01/08-2721, Trial Chamber III, *Decision on the Admission into Evidence of Items Deferred in the Chamber's Decision on the Prosecution's Application for Admission of Materials into Evidence Pursuant to Article 64(9) of the Rome Statute" (ICC-01/05-01/08-2299)*, 27 June 2013, para. 25.

[34] *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore.

[35] *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore.

[36] 007790-007799-ET ("Parathënia e Arkivave të RKL-së"), SPOE00053559-SPOE00053559-ET, SPOE00054158-SPOE00054160-ET, SPOE00054694-SPOE00054694-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1A dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1A, 2D, 3A SPOE00053559-SPOE00053559-ET, SPOE00054158-SPOE00054160-ET, SPOE00054694-SPOE00054694-ET.

[37] *Shih p.sh.* Shtojcën 3 Mocionit të Provave Jogojore: komunikata 70 e Shtabit të Përgjithshëm, materiali 1M (007887-007887-ET), komunikata 71 e Shtabit të Përgjithshëm, materiali 1Q (007897-007899-ET), komunikata 72 e SHP-së, materiali 1X (007999-008000-ET) (i shënuar si komunikata 32 sipas një gabimi shtypi), komunikata 73 e SHP-së, materiali 1C2 (008082-008083-ET), komunikata 74 e SHP-së, materiali 1F2 (008108-008111-ET), dhe komunikata 77 e SHP-së, materiali 1Q2 (008390-008392-ET); *Shih p.sh.* Shtojcën 4: komunikata 68 e SHP-së, materiali 1B (SPOE00053560-SPOE00053560-ET i rishikuar), komunikata 69 e SHP-së, materiali 1I (SPOE00053593-SPOE00053594-ET i rishikuar), komunikata 70 e SHP-së, materiali 1V (SPOE00053709-SPOE00053710-ET i rishikuar), komunikata 71 e SHP-së, materiali 1B2 (SPOE00053732-SPOE00053733-ET), komunikata 72 e SHP-së, materiali 1M2 (SPOE00053852-SPOE00053853-ET i rishikuar), komunikata 73 e SHP-së, materiali 1Q2 (SPOE00053946-SPOE00053947-ET i rishikuar), komunikata 74 e SHP-së, materiali 1T2 (SPOE00053974-SPOE00053977-ET i rishikuar),

Përgjithshëm;[38] (iii) dekrete të Qeverisës së Përkohshme të Kosovës ("QPK");[39] (iv) deklarata të përfaqësuesve të UÇK-së dhe të QPK-së;[40] (v) raporte dhe komunikata të zonave operative ("ZO");[41] (vi) raporte të aktiviteteve dhe strukturës organizative në zona operative të ndryshme;[42] (vii) politika institucionale të transmetuara për publikun;[43] (viii) raporte të lajmeve për operacione ushtarake,[44] ndalime,[45] ose zhvillime të tjera më të përgjithshme lidhur

---

komunikata 75 e SHP-së, materiali 1A3 (SPOE00054064-SPOE00054065-ET i rishikuar), komunikata 77 e SHP-së, materiali 2I (SPOE00054361-SPOE00054361-ET).

[38] *Shih p.sh.* Shtojcën3: dekreti politik 29 i SHP-së, materiali 1U (007990-007991-ET), dekreti politik 30 i SHP-së, materiali 1V (007993-007994-ET) dhe dekreti politik 34 i SHP-së, materiali 1U2 (008467-008469-ET i rishikuar); *Shih p.sh.* Shtojcën 4: dekreti politik 23 i SHP-së, materiali 1R (SPOE00053653-SPOE00053654-ET), dekreti politik 25 i SHP-së, materiali 1H2 (SPOE00053790-SPOE00053791-ET), dekreti politik 32 i SHP-së, materiali 1Z2 (SPOE00054049-SPOE00054050-ET), dhe dekreti politik 34 i SHP-së, materiali 2L (SPOE00054507-SPOE00054508-ET).

[39] *Shih p.sh.* Shtojcën 3: dekreti 81 i QPK-së, materiali 1A3 (008551-008552-ET) dekretet 83-85 të QPK-së, materiali 1C3 (008557-008560-ET, pranuar P00113-ET); *Shih p.sh.* Shtojcën 4: dekreti 81 i QPK-së, materiali 3H (SPOE00054880-SPOE00054881-ET), dekretet 83-86 të QPK-së, materiali 3I (SPOE00054898-SPOE00054902-ET), dekreti 87 i QPK-së, materiali 3O (SPOE00054965-SPOE00054966-ET).

[40] *Shih p.sh.* 007836-007836-ET, 008088-088092-ET, 008295-008296-ET, 008912-008913-ET, SPOE00053662-SPOE00053665-ET, SPOE00053753-SPOE00053755-ET, SPOE00053771-SPOE00053774-ET, SPOE00054593-SPOE00054594-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1G, 1D2, 1M2, 1U3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1S, 1D2, 1F2, 2R.

[41] *Shih p.sh.* 007820-007820-ET, 007880-007881-ET, 007883-007883-ET, 007990-007991-ET, 008015-008016-ET, SPOE00053562-SPOE00053563-ET, SPOE00053729-SPOE00053730-ET, SPOE00053796-SPOE00053797-ET, SPOE00054513-SPOE00054514-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1E, 1J, 1K, 1U, 1Y dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1C, 1A2, 1I2, 2M.

[42] *Shih p.sh.* 007945-007945-ET , 008088-088092-ET, 008405-008407-ET, 008679-008679-ET, 008918-008919-ET, SPOE00053600-SPOE00053602-ET, SPOE00053611-SPOE00053613-ET, SPOE00053667-SPOE00053667-ET, SPOE00053790-SPOE00053791-ET, SPOE00053837-SPOE00053837-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1S,1D2, 1S2, 1G3, 1W3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1K, 1O, 1T, 1H2, 1K2.

[43] *Shih p.sh.* 007897-007899-ET, 007948-007949-ET (pranuar P00115-ET), SPOE00053608-SPOE00053609-ET, SPOE00053732-SPOE00053733-ET, SPOE00053796-SPOE00053797-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1Q, 1T (pranuar P00115-ET) dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1N, 1B2,1I2.

[44] *Shih p.sh.* 007813-007813-ET, 007820-007820-ET, 007883-007883-ET, 007887-007887-ET, SPOE00053578-SPOE00053578-ET, SPOE00053593-SPOE00053594-ET i rishikuar, SPOE00053709-SPOE00053710-ET i rishikuar; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1D, 1E, 1K, 1M dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1F, 1I, 1V.

[45] *Shih p.sh.* 007860-007861-ET, 007909-007909-ET, SPOE00053604-SPOE00053604-ET, SPOE00053611-SPOE00053613-ET, SPOE00053667-SPOE00053667-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1H, 1R dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1L, 1O, 1T.

me konfliktin dhe/ose UÇK-në;[46] (ix) deklarata që u atribuohen të akuzuarve;[47] (x) lista të materialeve burimore dhe bibliografive[48] (së bashku "materialet me shkrim"); dhe (xi) një grup fotografish.[49]

(a) Materialet me shkrim:

18. Sa i përket relevancës, ZPS-ja synon të përdorë materialet në Shtojcat 3 dhe 4 midis të tjerash në lidhje me temat në vijim që janë relevante për Aktakuzën: (i) komanda dhe kontrolli i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; (ii) monitorimi dhe mbikëqyrja e zonave operative nga Shtabi i Përgjithshëm; (iii) niveli i organizimit të Shtabit të Përgjithshëm; (iv) ekzistenca e konfliktit të armatosur; dhe (v) politika e pretenduar e SHP-së e vënies në shënjestër të bashkëpunëtorëve të pretenduar dhe të tjerëve që perceptoheshin si kundërshtarë.[50] ZPS-ja gjithashtu synon të mbështetet në materiale të provave të propozuara në mbështetje të akuzave konkrete përfshirë ato në lidhje me ngjarjet që pretendohet se ndodhën në vendet në vijim apo afër tyre: Llapashticë midis nëntorit 1998 dhe marsit 1999;[51] Kleçkë midis nëntorit 1998 dhe qershorit 1999;[52] Bare dhe Bajgorë midis gushtit 1998 dhe

---

[46] *Shih p.sh.* 007797-007798-ET, 007806-007807-ET, 007813-007813-ET, 007829-007829-ET, 008931-008935-ET, SPOE00053574-SPOE00053575-ET, SPOE00053591-SPOE00053591-ET, SPOE00054019-SPOE00054019-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1B, 1C, 1D, 1F, 1Y3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1E, 1G, 1Y2.

[47] *Shih më poshtë* poshtëshënimet 92-95.

[48] *Shih* SPOE00054086-SPOE00054086-ET, SPOE00055194-SPOE00055194-ET, SPOE00055674-SPOE00055674-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1B3, 3C2, 4L2.

[49] 007789-008966, f. 008172-008185, 008172-008185-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 1H2.

[50] *Shih* Mocionin e Provave Jogojore, para. 23, 26.

[51] F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar* ("Aktakuza"), 30 shtator 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (riklasifikuar si konfidenciale më 26 janar 2023), para. 71-73, 107-108, (versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00999/A03). *Shih gjithashtu* 007813-007813-ET, 007860-007861-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1D, 1H.

[52] Aktakuza, para. 78-79, 115-116, 161-165; 007909-007909-ET, 008088-088092-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1R, 1D2.

mesit të shtatorit 1998;[53] dhe Kukës midis majit dhe qershorit 1999.[54] Relevanca e supozuar e këtij materiali pasqyrohet gjithashtu në Dosjen Paraprake të ZPS-së. ZPS-ja citon disa materiale nga Shtojca 3 e Dosjes Paraprake të ZPS-së në mbështetje të pretendimeve të veta,[55] duke theksuar lidhjen midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, RKL-së, dhe agjencisë së lajmeve *Kosovapress* dhe si i përdori Shtabi i Përgjithshëm këto subjekte për të shpërndarë mesazhet e veta.[56]

19. Materiali në Shtojcat 3 dhe 4 është relevant për pretendimet në Dosjen Paraprake të ZPS-së dhe në Aktakuzë sepse ka lidhje me: (i) qëndrimin zyrtar të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për aspekte dhe ngjarje të ndryshme, (ii) komandën dhe kontrollin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe monitorimin dhe mbikëqyrjen e zonave operative, (iii) nivelin e organizimit të tyre, dhe (iv) veprave penale konkrete që pretendohet se u kryen në zona operative të ndryshme.[57]

20. Sa i përket autenticitetit *prima facie* të arkivave të RKL-së, Trupi Gjykues vë në dukje se Shtojca 3 përmban ballinën e vëllimeve dhe stemën me ngjyra të UÇK-së, të rrethuar me fjalët "Radio-Kosova e Lire" dhe "94.2 FM" – që supozohet se janë brezi i frekuencës dhe stacioni prej të cilit transmetonte RKL-ja.[58] Botuesi, vendi dhe viti i botimit jepen si Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, 2009 në faqen e

[53] Aktakuza, para. 70, 106, 156; 008015-008016-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1Y.
[54] Aktakuza, para. 82, 119-120, 167; 008758-008758-ET, 008768-008769-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1M3, 1N3.
[55] F00709/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Dosjes Paraprake të Korrigjuar të Prokurorisë dhe Kërkesave në lidhje me Të* ("Dosja Paraprake e ZPS-së"), 24 shkurt 2022, konfidenciale, (versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 15 shkurt 2023, F01296/A01), para. 59, 65, 111.
[56] *Shih* Dosjen Paraprake të ZPS-së, para. 58, 66, 107.
[57] *Shih në përgjithësi* Shtojcën 3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore; *Shih gjithashtu* Mocionin e Provave Jogojore, para. 23-26.
[58] 007789-008966, f. 007789; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.

parë.[59] Faqja tjetër identifikon redaktorin, Nezir Myrtaj, tre anëtarë të ekipit redaktorial dhe jep të dhëna për autorët e titujve dhe të faqosjes.[60] Të gjitha këto rrethana tregojnë se këto vëllime janë botime autentike. Faqja e brendshme e fletës së fundit në secilin vëllim përmban numrin ISBN,[61] që tregon gjithashtu se këto vëllime janë materiale të botuara në mënyrë profesionale. Radiotransmetimet janë të renditura sipas datës dhe në rend kronologjik.[62]

21. Në Shtojcën 4, arkivat e agjencisë së lajmeve *Kosovapress* përmbajnë tregues të ngjashëm se janë autentikë dhe janë seri e vëllimeve të botuara në mënyrë profesionale. Ballina dhe faqja e fundit përmbajnë stemën me ngjyra të UÇK-së.[63] Botuesi, "Instituti i Historisë", dhe stema e tij janë paraqitur në mënyrë të dukshme.[64] Faqja e fundit përmban numrin ISBN 978-9951-409-47-6 dhe barkodin përkatës.[65] Vendi dhe viti i botimit, Prishtinë, 2016, janë dhënë në ballinë.[66] Berat Luzha identifikohet si përgatitës i materialit për publikim.[67] Sabit Syla figuron si kryeredaktor, Sabile Keçmezi-Basha dhe Hamit Kaba figurojnë si lektorë, Teuta Shala-Peli figuron si redaktore teknike, dhe Mrika Limani figuron si përkthyese në anglishte.[68] Parathënia është shkruar nga Rexhep Qosja, Sabile Keçmezi-Basha

---

[59] 007789-008966, f. 007790; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[60] 007789-008966, f. 007791; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[61] 007789-008966, f. 008205(ku jepen numrat e ISBN-së 978-9951-418-08-9 dhe 978-9951-418-09-6 për Vëllimin I); 008609 (ku jepen numrat e ISBN-së 978-9951-418-08-9 dhe 978-9951-418-10-2 për Vëllimin II); dhe 008966 (ku jepen numrat e ISBN-së 978-9951-418-08-9 dhe 978-9951-418-11-9 për Vëllimin III); *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[62] *Shih në përgjithësi* 007789-008966; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[63] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053504; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[64] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053504; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[65] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053504; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[66] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053506; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[67] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053506; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[68] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053508; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.

dhe Hamit Kaba.[69] Vëllimet gjithashtu përmbajnë listat e materialit burimor dhe bibliografitë.[70] Këto karakteristika janë në përputhje me një botim autentik.

22. Personat e përfshirë në botimin e këtyre vëllimeve gjithashtu përforcojnë autenticitetin e tyre. Rexhep Qosja është identifikuar nga vetë Thaçi si një prej këshilltarëve të tij gjatë periudhës që mbulon aktakuza.[71] Tri vëllimet e librit, që përbëjnë Shtojcën 3, i ka redaktuar Nezir Myrtaj, i cili gjithashtu përmendet në parathënien e vëllimit të parë, shkruar në korrik 2009.[72] Një fotografi me mbishkrim e Nezir Myrtajt është përfshirë në libër dhe identifikon atë si një prej redaktorëve të parë të RKL-së.[73] Në parathënie, Nezir Myrtaj vë në dukje se (i) krijimi i RKL-së dhe agjencisë së lajmeve *Kosovapress* u bazua në një vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së; (ii) këto subjekte u bënë kronistët më të besueshëm të veprimeve të UÇK-së dhe materialet e dhëna përbëjnë arkivin autentik të fjalëve të folura, të shkruara dhe të transmetuara të UÇK-së; (iii) përmbajtja e tyre përfshinte komunikatat e lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së; (iv) ekipi redaktorial i transmetimit të lajmeve iu qas raportimit në mënyrë kritike, duke verifikuar saktësinë e përmbajtjes dhe duke sqaruar raportet kur ishte e nevojshme; dhe (v) Zyra e Kryeministrit ndihmoi botimin e këtyre vëllimeve në vitin 2009.[74] Siç është vënë në dukje nga ZPS-ja, në vitin 2009 kryeministër ishte z. Thaçi.[75]

---

[69] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053545; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[70] SPOE00054086-SPOE00054086-ET, SPOE00055194-SPOE00055194-ET, SPOE00055674-SPOE00055674-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1B3, 3C2, 4L2.
[71] SPOE00055434-SPOE00055436-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 4T.
[72] Parathënia e Arkivave të RKL-së, f. 007794; *Shih* Shtojcën 3 e Mocionit të provave Jogojore, materiali 1A.
[73] 007789-008966, f. 008176; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[74] Parathënia e Arkivave të RKL-së, f. 007794.
[75] *Shih* diskutimin e ZPS-së të autenticitetit të 007789-008966 në Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.

23. Arkivat e agjencisë së lajmeve *Kosovapress* i përpiloi dhe i redaktoi Berat Luzha.[76] Në SPOE00055393-SPOE00055394-ET,[77] Berat Luzha identifikohet dhe intervistohet si shefi i agjencisë së lajmeve *Kosovapress*. Në këtë rol, atij i kërkohej të kishte njohuri të përgjithshme të mesazheve dhe shpërndarjes së informacionit përmes RKL-së dhe Kosovapressit. Në parathënie, z. Luzha vë në dukje se RKL-ja dhe Kosovapress ishin instrumente të fuqishme të UÇK-së, dhe se anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishin kyç për suksesin e tyre.[78] Gjithashtu në parathënie, historianët Sabile Keçmezi-Basha dhe Hamit Kaba vënë në dukje se përmbajtja e librit të agjencisë së lajmeve *Kosovapress* jep të dhëna historike se çka kishte ndodhur në të vërtetë, duke bërë dallimin midis versionit serb të rremë të ngjarjeve dhe "të vërtetës" dhe "realitetit" që pasqyrojnë materialet e agjencisë së lajmeve *Kosovapress*.[79] Identifikimi dhe përfshirja e këtyre personave, dhe njohuritë e tyre personale i japin besueshmëri idesë se përmbajtja e këtyre vëllimeve pasqyron ato që ishin transmetuar realisht.

24. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është bindur se të dhënat në arkivat e RKL-së dhe në arkivat e agjencisë së lajmeve *Kosovapress* janë autentike *prima facie*, bazuar në paraqitjen e tyre fizike, përmbajtjen e tyre dhe pjesëmarrjen e personave për të cilët mund të përfundohet në mënyrë të arsyeshme se kishin njohuri personale për funksionimin e RKL-së dhe të agjencisë së lajmeve *Kosovapress*.

25. Pretendimet e ZPS-së në lidhje me vlerën provuese bazohen në sugjerimin për lidhjen midis RKL-së dhe agjencisë së lajmeve *Kosovapress* në njërën anë dhe

---

[76] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053506; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[77] *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 4L.
[78] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00052556-SPOE00053558; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[79] SPOE00053504-00054088, f. SPOE0053551-SPOE00053552; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.

Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në anën tjetër.[80] ZPS-ja pohon se UÇK-ja i përdori këto media për të transmetuar qëndrimet dhe politikat zyrtare të UÇK-së, përfshirë përmes raporteve, komunikatave dhe deklaratave. ZPS-ja sugjeron se këto materiale pasqyrojnë njohuritë, strukturën dhe politikat e Shtabit të Përgjithshëm, sepse deklaratat që përmbajnë ato buronin dhe u miratuan nga UÇK-ja.[81]

26. Edhe pse ekzistenca dhe lloji i marrëdhënieve midis UÇK-së dhe RKL-së e agjencisë së lajmeve *Kosovapress* janë konstatime faktesh që duhet të përcaktohen në fund të çështjes duke marrë parasysh të gjitha provat përkatëse,[82] Trupi Gjykues do të shqyrtojë nëse është demonstruar *prima facie* lidhja midis UÇK-së dhe RKL-së e agjencisë së lajmeve *Kosovapress* për vlerësimin e relevancës dhe vlerës provuese të materialeve në Shtojcën 3 dhe Shtojcën 4.

27. Komunikata nr. 62 e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, botuar më 15 nëntor 1998 në "Koha Ditore", jep informacion të përgjithshëm në lidhje me ristrukturimin e vazhdueshëm të UÇK-së.[83] Midis gjërave të tjera, aty jepet dhe theksohet pakënaqësia e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së me mënyrën se si mediat raportonin aktivitetet e tij.[84] Kjo duket të ketë qenë burimi, si dhe arsyetimi, për vendimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për të krijuar dhe themeluar

---

[80] Mocioni i Provave Jogojore, para. 23, 26; *Shih në përgjithësi* shtyllën "Relevanca/Vlera provuese" të Shtojcës 3 të Provave Jogojore, materiali 1, dhe të Shtojcës 4 të Provave Jogojore, materiali 1.
[81] *Ibid*.
[82] *Shih p.sh.* Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Provat Jogojore, para. 172, 178; ICTY, *Prosecutor v. Vojislav Ŝeŝelj*, IT-03-67-T, Trial Chamber III, *Decision on Prosecution's Second Motion for Admission of Evidence from the Bar Table and for an Amendment to the 65 ter Exhibit List*, 23 December 2010, para. 19.
[83] U008-1624-U008-1624-ET i rishikuar; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2T; *Shih* Vendimin e Tretë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 53(b) (duke pranuar si provë komunikatën 62).
[84] U008-1624-U008-1624-ET i rishikuar, f. 2 (ku thuhet "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së qorton TV-në satelitore të Prishtinë dhe mediat e tjera në botën e jashtme dhe në vend dhe u kërkon të mos shtrembërojnë thirrjet tona për unitet të veprimit tonë 'Vendi në rrezik – vendlindja thërret', siç thuhet në deklaratën politike nr. 18. Manipulime të tilla shkelin jo vetëm parimet demokratike dhe etikën gazetareske, por gjithashtu janë veprime të dënueshme."); *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 2T.

mediat e veta për të propaganduar qëndrimet dhe politikat e veta. Fakti që RKL-ja dhe Kosovapress u krijuan nga UÇK-ja si përgjigje ndaj këtyre problemeve konfirmohet në transmetimin e parë të RKL-së dhe në Arkivat.[85]

28. Në komunikatën nr. 68, të botuar në "Zëri i Kosovës" më 7 janar 1999, dhe drejtuar mediave, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së njoftoi zyrtarisht krijimin e këtyre mediave dhe artikuloi arsyetimin konkret për themelimin e tyre.[86] Në arkivat e RKL-së për maj/qershor (1999) theksohet qartë bashkërendimi i qëndrimeve të UÇK-së /QPK-së me ato të shprehura nga RKL-ja.[87]

29. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se është demonstruar mjaftueshëm *prima facie* lidhja institucionale dhe juridikisht thelbësore midis këtyre subjekteve dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për të përcaktuar relevancën dhe vlerën provuese *prima facie* të këtyre materialeve. Rrjedhimisht, materialet e dhëna në Shtojcat 3 dhe 4 kanë vlerë provuese *prima facie* në lidhje me pikat e trajtuara në konstatimet e Trupit Gjykues mbi relevancën.[88] Përmbajtja e

[85] *Shih* Parathënien e Arkivave të RKL-së, f. 007798.
[86] SPOE00053560-SPOE00053560-ET i rishikuar; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1B. *Shih gjithashtu* Parathënien e Arkivave të RKL-së, f. 007792.
[87] 008725-008726-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1K3 ku thuhet:

> Shënim (RKL) /Radio Kosova e Lirë/: Koncepti redaktorial i Radios "Kosova e Lirë" është i orientuar fuqishëm në përkrahjen e parezervë të luftës sonë çlirimtare kundër armikut barbar serb. Ajo ndjek rreptësisht vijën e luftës që Ushtria Çlirimtare e Kosovës e ka ndjekur për disa kohë, luftë e cila – pavarësisht se sa e pabarabartë që është – e ka bërë zërin e çlirimit të dëgjohet dhe të merret shumë më seriozisht se zëri i partive politike pacifiste të Kosovës që kanë qenë të pranishme me vite.
> Kritikat që "Kosova e Lirë" drejton ndaj klaneve politike të caktuara bëhen me mbështetjen e SHP të UÇK-së, Qeverisë së Kryeministër Hashim THAÇIT, dhe Qeverisë së Shqipërisë. Të gjitha makinacionet që bien ndesh me këtë konstelacion të forcave të bashkërenditura kombëtare do të mbeten cak i kritikave tona, të kundërshtimit tonë të fuqishëm; sepse dy realitete, dy qeveri, ose dy ushtri dhe përpjekje hipokrite si këto nuk do të pranohen për fatin dhe të ardhmen e popullit të Kosovës.
> Duke qenë në shërbim të ushtrisë dhe popullit tonë të përvuajtur, ne nuk do të bëjmë asnjë kompromis me Beogradin, dhe as me njerëzit që përkrahin ardhmërinë e Kosovës me krijimin e mirëkuptimit dhe besimit në mbeturinat e Jugosllavisë.

[88] *Shih më lart* para. 18-19.

Shtojcave 3 dhe 4 gjithashtu jep njohuri për përdorimin nga UÇK-ja të propagandës, mesazheve dhe komunikatave.[89]

30. Gjithashtu, vlera e tyre provuese shtohet kur përmbajtja materiale e materialeve në Shtojcën 3 krahasohet me materialet përkatëse në Shtojcën 4.[90] Trupi Gjykues vë në dukje në këtë aspekt se përmbajtja e materialeve në Shtojcën 3 konfirmon në masë të konsiderueshme materialet e datave të njëjta apo të ngjashme në Shtojcën 4, dhe e kundërta. Zgjedhjet e përmbajtjes dhe temës janë përgjithësisht përputhëse, ashtu si dhe gjuha e përdorur për të shprehur mendime për tema të zgjedhura. Kjo përputhshmëri gjithashtu mund të vërehet kur materiale konkrete në Shtojcat 3 dhe 4 krahasohen me materialet e botuara në revista të tjera, siç është "Zëri i Kosovës".[91]

31. Shtojcat 3 dhe 4 përmbajnë raporte të gazetave dhe të transmetimeve të intervistave të pretenduara të të akuzuarve,[92] dekrete të nënshkruara,[93] deklarata,[94]

---

[89] *Shih gjithashtu* Vendimin e Dytë të Provave Jogojore, para. 37.
[90] *Ibid.*
[91] *Krahaso p.sh.* SPOE00053560-SPOE00053560-ET i rishikuar (Shtojca 4 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1B) *me* SPOE00056419-SPOE00056419 (Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 64); SPOE00053662-SPOE00053665-ET (Shtojca 4 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1S) *me* SPOE00056467-SPOE00056467 (Shtojca 1 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 60); *Shih gjithashtu* SPOE00053683-SPOE00053684-ET (Shtojca 4 e Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1U) (raport nga *Kosovapress* ku vihet në dukje se artikujt e vet tani janë në internet dhe shpesh botohen në gazetën "Zëri i Kosovës").
[92] **Z. Thaçi:** 008740-008745-ET, SPOE00053962-SPOE00053964-ET, SPOE00053982-SPOE00053986-ET, SPOE00055085-SPOE00055085-ET, SPOE00055116-SPOE00055118-ET, SPOE00055431-SPOE00055433-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1L3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1S2, 1U2, 3X, 3Z, 4S.
**Z. Krasniqi:** 008718-008720-ET, SPOE00053568-SPOE00053569-ET, SPOE00053625-SPOE00053627-ET, SPOE00053783-SPOE00053785-ET, SPOE00053982-SPOE00053986-ET, SPOE00054139-SPOE00054144-ET, SPOE00055290-SPOE00055292-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1J3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1D, 1Q, 1G2, 1U2, 2B, 4E.
[93] **Z. Thaçi:** 008557-008560-ET, 008644-008644-ET (pranuar si P00113-ET), SPOE00054880-SPOE00054881-ET, SPOE00054898-SPOE00054902-ET, SPOE00054901-SPOE00054901-ET, SPOE00054965-SPOE00054966-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1C3 (pranuar si P00113-ET), 1D3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 3H, 3I, 3J, 3O.
**Z. Krasniqi:** SPOE00055043-SPOE00055044-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 3T.
[94] **Z. Thaçi:** 008656-008656-ET, 008758-008758-ET, 008768-008769-ET, 008819-008820-ET, SPOE00053662-SPOE00053665-ET, SPOE00054019-SPOE00054019-ET, SPOE00054541-SPOE00054541-

dhe përmbushjet e roleve të tyre konkrete dhe veprimeve të marra si pjesë e UÇK-së dhe/ose të QPK-së.[95] Mbrojtja kundërshton artikujt në media që i atribuojnë deklarata UÇK-së ose cilitdo prej të akuzuarve[96] sepse ato përbëjnë prova të dorës së dytë dhe sepse Mbrojtja pretendon se nuk është në gjendje t'i ballafaqojë deklaratat dhe rrethanat e tyre për të hedhur dyshime mbi besueshmërinë e tyre.[97]

32. Trupi Gjykues vë në dukje dhe përsërit se, edhe pse nuk ekziston barrierë procedurale për pranimin e provave të dorës së dytë,[98] Trupi Gjykues nuk mund

---

ET, SPOE00054557-SPOE00054558-ET, SPOE00054919-SPOE00054919-ET, SPOE00055029-SPOE00055030-ET; SPOE00055067-SPOE00055070-ET, SPOE00055085-SPOE00055085-ET, SPOE00055305-SPOE00055306-ET, SPOE00055319-SPOE00055319-ET, SPOE00055636-SPOE00055636-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1E3, 1M3, 1N3, 1O3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1S, 1Y2, 2P, 2Q, 3L, 3R, 3U, 3X, 4F, 4G, 4K2.

**Z. Selimi:** SPOE00055626-SPOE00055627-ET; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 4I2.

**Z. Krasniqi:** 007893-007894-ET, 008701-008702-ET, SPOE00053796-SPOE00053797-ET, SPOE00055265-SPOE00055266-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1P, 1H3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1I2, 4B.

[95] **Z. Thaçi:** 008374-008374-ET, 008402-008402-ET, 008467-008469-ET i rishikuar, 008555-008555-ET, 008667-008669-ET, 008758-008758-ET, 008768-008769-ET, SPOE00054134-SPOE00054134-ET, SPOE00054245-SPOE00054246-ET, SPOE00054377-SPOE00054377-ET, SPOE00054507-SPOE00054508-ET, SPOE00055071-SPOE00055071-ET, SPOE00055145-SPOE00055145-ET, SPOE00055323-SPOE00055325-ET SPOE00055349-SPOE00055350-ET, SPOE00055385-SPOE00055385-ET, SPOE00055418-SPOE00055418-ET, SPOE00055420-SPOE00055421-ET, SPOE00055427-SPOE00055427-ET, SPOE00055428-SPOE00055429-ET, SPOE00055434-SPOE00055436-ET, SPOE00055470-SPOE00055471-ET, SPOE00055479-SPOE00055480-ET, SPOE00055488-SPOE00055489-ET, SPOE00055516-SPOE00055517-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1P2, 1R2, 1U2, 1B3, 1F3, 1M3, 1N3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2A, 2G, 2J, 2L, 3V, 3A2, 4H, 4I, 4K, 4O, 4P, 4Q, 4R, 4T, 4V, 4W, 4X, 4Y.

**Z. Veseli:** 008667-008669-ET, SPOE00055071-SPOE00055071-ET, SPOE00055145-SPOE00055145-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1F3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 3V, 3A2.

**Z. Selimi:** 008667-008669-ET, SPOE00055071-SPOE00055071-ET, SPOE00055145-SPOE00055145-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1F3 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 3V, 3A2.

**Z. Krasniqi:** 007797-007798-ET, 007829-007829-ET, 007888-007889-ET, 008236-008237-ET, 008264-008264-ET, 008374-008374-ET, 008402-008402-ET, 008495-008495-ET, SPOE00053742-SPOE00053743-ET, SPOE00054134-SPOE00054134-ET, SPOE00054377-SPOE00054377-ET, SPOE00055282-SPOE00055282-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1B, 1F, 1N, 1J2, 1K2, 1P2, 1R2, 1Y2 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1C2, 2A, 2J, 4D.

[96] Përgjigjja, para. 59-60.

[97] Përgjigjja, para. 59.

[98] KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykues II, *Versioni i Redaktuar Publik i Aktgjykimit* ("Aktgjykimi i Gucatit dhe Haradinajt"), 18 maj 2022, para. 24 (citing ICC, *Prosecutor v. Mathieu Ngudjolo Chui*, ICC-

të pranojë prova të dorës së dytë në atë mënyrë që ndërhyn padrejtësisht në të drejtat e të akuzuarve.[99]

33. Gjatë vlerësimit nëse vlera provuese e cilitdo prej këtyre materialeve zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre, Trupi Gjykues kujton Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, në të cilin konstatoi se natyra e pretenduar propagandistike ose e ekzagjeruar e komunikatave nuk i bënte ato të papranueshme.[100] Trupi Gjykues vë në dukje se, edhe pse materiale të veçanta nuk u atribuohen personave konkretë dhe përmbajnë informacion të dorës së dytë, Trupi Gjykues mund t'i shqyrtojë këto probleme duke u dhënë peshën e duhur këtyre materialeve dhe duke i shpërfillur pretendimet ose pohimet që nuk mbështeten mjaftueshëm në fakte në momentin e kuvendimeve përfundimtare. Trupi Gjykues do të përcaktojë, mbi bazë të të gjitha provave të administruara, se çfarë qëllimi ose qëllime synonin të përdoreshin dhe ishin përdorur këto materiale.

34. ZPS-ja parashtron se shumë prej këtyre materialeve do të përdoren së paku për të vërtetuar se të akuzuarit kishin poste me pushtet në UÇK.[101] Rrjedhimisht, ZPS-ja synon të mbështetet në këto materiale, së paku pjesërisht, për të vërtetuar fakte dhe rrethana relevante për vërtetimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarve për krimet në aktakuzë. Trupi Gjykues ka marrë parasysh këtë kur vendosi që të pranoheshin këto dokumente. Fakti që një dokument përmban prova të 'veprimeve dhe sjelljes' së të akuzuarve megjithatë nuk përbën arsye të pavarur për përjashtimin e provave materiale të propozuara. Trupi Gjykues gjithashtu ka marrë parasysh faktin që Mbrojtja do të jetë në gjendje të verifikojë përmbajtjen e

---

01/04-02/12A, Appeals Chamber, *Judgment on the Prosecutor's Appeal Against the Decision of Trial Chamber II entitled "Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute"*, 7 April 2015, para. 226; ICC, *Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13A, Appeals Chamber, *Public Redacted Judgment on the Appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, et al. against the Decision of Trial Chamber VII entitled "Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute"*, 8 March 2018, para. 874).

[99] Aktgjykimi i Gucatit dhe Haradinajt, para. 25.

[100] Vendimi i Dytë Mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 75.

[101] *Shih në përgjithësi*, Shtojcat 3 dhe 4 të Mocionit të Provave Jogojore, pjesa "Relevanca/Vlera provuese" në materialin e përfshirë në poshtëshënimet 92-95.

këtyre dokumenteve përmes dëshmitarëve që ende nuk janë thirrur nga ZPS-ja. Gjithashtu, kur kufizohet aftësia e Mbrojtjes për të kundërshtuar përmbajtjen e dokumenteve të caktuara (ose autorësinë e tyre), Trupi Gjykues do ta marrë këtë parasysh gjatë vlerësimit se çfarë peshe dhe vlere provuese, nëse kanë, t'u japë këtyre materialeve. Trupi Gjykues do të marrë gjithashtu parasysh, sipas rastit, praninë ose jo të autorëve të përmendur me emër, që mund të ndikojë edhe më tej në peshën, nëse kanë, që Trupi Gjykues mund të jetë i gatshëm t'i japë një prove materiale të caktuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është bindur se vlera provuese e materialeve nuk zhbëhet nga efekti i tyre dëmtues.

(b) Fotogaleria

35. ZPS-ja kërkon pranimin e 25 fotografive dhe mbishkrimeve përkatëse të tyre që mbulojnë 14 faqe të Shtojcës 3.[102] ZPS-ja parashtron se këto fotografi janë relevante dhe me vlerë provuese për ekzistencën e konfliktit të armatosur, për komunikimet, dhe për kontrollin dhe komandimin e UÇK-së.[103]

36. Mbrojtja i përfshin kundërshtimet e librit të artikuluara më parë në përgjithësi dhe artikuloi kundërshtime konkrete në lidhje me këto materiale.[104]

37. Relevanca duhet të përcaktohet duke u bazuar në përmbajtjen dhe kontekstin e fotografive.[105] Edhe pse në fotografi shihen burra dhe gra të armatosur dhe në uniforma, vetëm pak gjëra të tjera, si vendndodhja, mund të shihen në ato fotografi. Ngjashëm, z. Thaçi dhe z. Krasniqi duken në disa fotografi të errëta, që duket se janë bërë në shtëpi, por përsëri mungon konteksti dhe relevanca e pretenduar nuk mund të verifikohet. Fotografia e Nezir Myrtajt përbën përjashtim, në të cilën ai shihet duke shkruar para radiopajisjeve, mbishkrimi i të

[102] 007789-008966, f. 008172-008185, 008172-008185-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 1H2.
[103] 008172-008185-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1H2.
[104] *Ibid.*
[105] ICC, *Prosecutor v. Germain Katanga and Mathieu Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-2635, Trial Chamber II, *Decision on the Prosecutor's Bar Table Motions*, 17 December 2010, para. 24(d).

cilës e identifikon si redaktor të radiostacionit në atë kohë.[106] Nezir Myrtaj figuron si redaktor në vëllimet që përmban Shtojca 3.[107] Ai gjithashtu shkroi parathënien e vëllimeve.[108] Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se kjo fotografi është relevante.

38. Në lidhje me autenticitetin *prima facie*, ende vlejnë rrethanat e artikuluara më lart në lidhje me autenticitetin në përgjithësi të Shtojcës 3.[109] Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se kjo fotografi është autentike *prima facie*. Fotografia ka vlerë provuese për rolin e Nezir Myrtajt si redaktor i vëllimeve që përmban Shtojca 3. Trupi Gjykues gjithashtu konstaton se vlera provuese e fotografisë nuk zhbëhet nga efekti dëmtues i saj.

39. Bazuar në këto rrethana, ZPS-ja duhet të përgatisë një dokument ku figuron vetëm fotografia e Nezir Myrtajt që gjendet në faqen 008176 të 007789-008966, si dhe përkthimin në anglishte të mbishkrimit të fotografisë, siç është dhënë në faqen 008176-ET të 008172-008185-ET.

(c) Përfundim

40. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se të gjitha materialet që përmbajnë material me shkrim në Shtojcën 3 dhe Shtojcën 4 janë të pranueshme, me përjashtim të atyre materialeve që tashmë janë pranuar, që përmenden në paragrafin 10,[110] dhe atyre materialeve që janë paraqitur të plota në gjuhën shqipe, që përmenden në paragrafin 11.[111] Sa u përket fotografive që përmban Shtojca 3,

[106] 007789-008966, f. 008176; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[107] Parathënia e Arkivave të RKL-së, f. 007791; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1A.
[108] Parathënia e Arkivave të RKL-së, f. 007792-007796; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1A.
[109] *Shih më lart*, para. 20-28.
[110] 007948-007949-ET, SPOE00054318-SPOE00054320-ET, SPOE00054513-SPOE00054514-ET, SPOE00054519-SPOE00054522-ET, SPOE00054878-SPOE00054879-ET, SPOE00054898-SPOE00054902-ET; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1T dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2H, 2M, 2O, 3G, 3I.
[111] 007789-008966, SPOE00053504-00054088, SPOE00054089-00054655, SPOE00054656-00055197 and SPOE00055198-00055677; *Shih* Shtojcën 3 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1 dhe Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 2, 3, 4.

Trupi Gjykues konstaton se fotografia e vetme e Nezir Myrtajt është e pranueshme. Trupi Gjykues konstaton se fotografitë e tjera janë të papranueshme si prova jogojore.

**2. Shtojca 5 – Ribotimi i materialit të agjencisë së lajmeve *Kosovapress* në media të tjera.**

41. ZPS-ja pohon se materialet që përmban Shtojca 5 janë 20 artikuj lajmesh të agjencisë *Kosovapress* që i siguroi shërbimi monitorues i Korporatës Transmetuese Britanike ("BBC") dhe u ribotuan ndërkombëtarisht.[112] ZPS-ja parashtron se këto dokumente janë relevante, autentike dhe me vlerë provuese dhe se Mbrojtjes nuk i shkaktohet asnjë dëm me pranimin e tyre.[113]

42. Mbrojtja parashtron se mund të shkaktohet cenim i padrejtë në qoftë se nuk përcaktohet autorësia e deklaratave që përmbajnë këto publikime.[114] Mbrojtja gjithashtu argumenton se dokumentet: (i) nuk lidhen mjaftueshëm me elementet e akuzave ose format e përgjegjësisë në këtë çështje;[115] (ii) nuk provojnë ndonjë pikë relevante për çështjen apo të kundërtën e tyre;[116] dhe (iii) janë tepër dëmtuese.[117] Së fundi, Mbrojtja pohon se disa nga këto dokumente janë të rëndësisë thelbësore për argumentet e ZPS-së dhe rrjedhimisht duhet të pranohen përmes dëshmisë së drejtpërdrejtë.[118]

43. Sa i përket relevancës së dokumenteve në Shtojcën 5, Trupi Gjykues gjykon se përmbajtja e këtyre artikujve ka të bëjë me pika në lidhje me: (i) postet me pushtet të të akuzuarve, (ii) përfshirjen e tyre në aspekte të ndryshme të

[112] Mocioni i Provave Jogojore, para. 27.
[113] Mocioni i Provave Jogojore, para. 3.
[114] Përgjigjja, para. 59.
[115] *Shih në përgjithësi* Shtojcën 5 të Përgjigjes.
[116] *Shih në përgjithësi* Shtojcën 5 të Përgjigjes.
[117] *Shih në përgjithësi* Shtojcën 5 të Përgjigjes.
[118] 020411-020412, 020413-020413, 020644-020645, 020676-020679, 020694-020695, 020754-020755, 020760-020761, 020823-020825; *Shih* Shtojcën 5 të Përgjigjes, materialet 10, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 19.

funksionimit të qeverisë, (iii) qëndrimet e tyre politike dhe politikat e tyre, (iv) marrëdhënien hierarkike misi Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të zonave operative, dhe (v) ekzistencën e konfliktit të armatosur.[119] Meqenëse këto pika kanë të bëjnë me rrethanat dhe krimet që ZPS-ja i pretendon në Aktakuzë,[120] Trupi Gjykues konstaton se artikujt janë relevantë.

44. Sa i përket autenticitetit *prima facie* të dokumenteve në Shtojcën 5 të Kërkesës, secili material përmban logon e BBC-së, titullin origjinal, datën e botimit, si dhe burimin, gjuhën origjinale dhe datën e botimit në burimin origjinal. Gjithashtu, në 18 nga 19 materialet[121] "Kosovapress" figuron si burimi origjinal,[122] me përjashtim të 019602-019603, që si duket së pari u botua në "Koha Ditore".

45. Sa i përket autenticitetit të 019602-019603,[123] që duket se së pari u botua në "Koha Ditore", Trupi Gjykues vë në dukje se 019602-019603 është në përputhje me artikujt e tjerë të botuar në "Zëri i Kosovës"[124] dhe "Kosovapress".[125] Edhe në artikullin në "Zëri i Kosovës" edhe në atë në Kosovapress, të botuar disa ditë pas botimit të artikullit në "Koha Ditore", diskutohen pretendimet kundër Bujar Bukoshit dhe përmbajnë një apel drejtuar shqiptarëve etnikë që të distancohen nga qeveria e Bujar Bukoshit. Kështu, në artikujt në "Koha Ditore", "Zëri i Kosovës" dhe "Kosovapress" përdoret gjuhë e njëjtë apo shumë e ngjashme. Duke u bazuar

---

[119] Mocioni i Provave Jogojore, para. 28; *Shih në përgjithësi* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore.
[120] Aktakuza, para. 17-20, 32-57.
[121] N.B. edhe pse materialet në Shtojcën 5 përmbajnë numrat prej 1 deri në 20, numri 18 është kapërcyer, kështu që Shtojca 5 përmban 19 materiale, edhe pse numërtimi i përdorur të materialit shkon deri në 20.
[122] 019645-019645, 019664-019664, 019741-019741, 019764-019765, 021111-021111, 019779-019780, 019784-019785, 019786-019788, 020411-020412, 020413-020413, 020644-020645, 020657-020657, 020676-020679, 020694-020695, 020754-020755, 020760-020761, 020823-020825, 020881-020882); *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 2-17, 19, 20.
[123] *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.
[124] SPOE00056467-SPOE00056467-ET; *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 60.
[125] SPOE00053504-00054088, f. SPOE00053662-00053664; *Shih* Shtojcën 4 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 1.

në këto ngjashmëri dhe tregues të autenticitetit, Trupi Gjykues është bindur se 019602-019603 është autentik *prima facie*.

46. Sa u përket 18 materialeve të tjera që burojnë nga *Kosovapress*, Trupi Gjykues kujton konstatimin e vet në paragrafët 21 deri 23 në lidhje me autenticitetin e artikujve që burojnë nga *Kosovapress*.[126] Jo vetëm që dokumentet në Shtojcën 5 pasqyrojnë të njëjtin burim dhe kanë përmbajtje të njëjtë si dokumentet e pranuara, por ato gjithashtu përmbajnë tregues të publikimeve legjitime të BBC-së. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se artikujt në Shtojcën 5 janë autentikë *prima facie*.

47. Trupi Gjykues gjithashtu konstaton se dokumentet në Shtojcën 5 kanë vlerë provuese për ato pika të identifikuara më lart sa i përket relevancës.[127] Trupi Gjykues vë në dukje se, edhe pse materiale konkrete nuk u atribuohen personave konkretë, dhe në disa raste përmbajnë prova të dorës së dytë, Trupi Gjykues mund t'i trajtojë këto pika gjatë kuvendimeve përfundimtare duke u dhënë këtyre materialeve peshën e duhur, nëse kanë, dhe të mos i marrë parasysh pretendimet apo pohimet që nuk janë të vërtetuara mjaftueshëm. Trupi Gjykues do të konstatojë, duke u bazuar në të gjitha provat e paraqitura, se për çfarë qëllimi ose qëllimesh synohej të përdoreshin këto materiale. Trupi Gjykues është bindur se të akuzuarit nuk do të pësojnë asnjë dëm të padrejtë nëse pranohen këto materiale.

48. Mbrojtja konkretisht kundërshton artikujt në media që i atribuojnë deklarata UÇK-së ose të akuzuarve sepse Mbrojtja nuk është në gjendje të ballafaqojë këto deklarata dhe rrethanat në të cilat u bënë dhe sepse pranimi i tyre si prova jogojore pamundëson vlerësimin e duhur të pranueshmërisë.[128] Sikurse Shtojcat 3 dhe 4, Shtojca 5 përmban artikuj në gazeta për intervista të pretenduara të të

---

[126] *Shih më lart*, poshtëshënimet 63-79.
[127] *Shih më lart*, para. 43.
[128] Përgjigjja, para. 59-60.

akuzuarve,[129] dekrete të nënshkruara,[130] deklarata,[131] dhe përmbushjen e roleve konkrete dhe veprimeve të ndërmarra si pjesë e UÇK-së dhe/ose QPK-së.[132] Analiza dhe qasja e miratuar prej Trupit Gjykues më lart zbatohet për ato materiale në Shtojcën 5.[133] Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është bindur se efekti dëmtues i provave të propozuara në Shtojcën 5 nuk e zhbën vlerën provuese të tyre.

(a) Përfundim:

49. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se të gjitha materialet në Shtojcën 5 janë të pranueshme.

## VI. VENDIM

50. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

a) **MIRATON** pjesërisht Mocionin e Provave Jogojore sa i përket Shtojcës 3 dhe Shtojcës 4;

b) **MIRATON** Mocionin e Provave Jogojore sa i përket Shtojcës 5;

c) **PRANON** si prova: 007790-007799-ET, 007797-007798-ET, 007806-007807-ET, 007813-007813-ET, 007820-007820-ET, 007829-007829-ET, 007836-007836-ET, 007860-007861-ET, 007873-007874-ET, 007880-007881-ET, 007883-007883-ET, 007884-007885-ET, 007887-007887-ET, 007888-

[129] **Z. Thaçi:** 019786-019788; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 9.
[130] **Z. Thaçi:** 020411-020412; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 10.
[131] **Z. Thaçi:** 019602-019603, 019664-019664, 019779-019780, 019784-019785, 020644-020645, 020657-020657, 020694-020695, 020823-020825; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 1, 3, 7, 8, 12, 13, 15, 19.
**Z. Krasniqi:** 019764-019765; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 5.
[132] **Z. Thaçi:** 019741-019741, 020676-020679, 020881-020882; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 4, 14, 20.
**Z. Veseli**: 019741-019741; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 4.
**Z. Selimi:** 019741-019741, 020881-020882; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materialet 4, 20.
**Z. Krasniqi:** 020881-020882; *Shih* Shtojcën 5 të Mocionit të Provave Jogojore, materiali 20.
[133] *Shih më lart*, para. 32-34.

007889-ET, 007891-007892-ET, 007893-007894-ET, 007897-007899-ET, 007909-007909-ET, 007945-007945-ET, 007990-007991-ET, 007993-007994-ET, 007996-007997-ET, 007999-008000-ET, 008015-008016-ET, 008034-008034-ET, 008064-008064-ET, 008075-008076-ET, 008082-008083-ET, 008088-088092-ET, 008098-008099-ET, 008108-008111-ET, 008168-008169-ET, mbishkrimin në faqen 008176-ET të 008172-008185-ET në lidhje me fotografinë e Nezir Myrtajt, fotografisë së Nezir Myrtajt që është në 007789-008966 në faqen 008176, 008227-008228-ET, 008236-008237-ET, 008264-008264-ET, 008279-008280-ET, 008295-008296-ET, 008344-008345-ET, 008348-008351-ET, 008374-008374-ET, 008390-008392-ET, 008402-008402-ET, 008405-008407-ET, 008458-008464-ET, 008467-008469-ET i rishikuar, 008471-008471-ET, 008481-008481-ET, 008488-008488-ET, 008495-008495-ET, 008532-008534-ET, 008551-008552-ET, 008555-008555-ET, 008656-008656-ET, 008667-008669-ET, 008679-008679-ET, 008701-008702-ET, 008707-008707-ET, 008718-008720-ET, 008725-008726-ET, 008740-008745-ET, 008758-008758-ET, 008768-008769-ET, 008819-008820-ET, 008850-008850-ET, 008865-008865-ET, 008874-008877-ET, 008891-008897-ET, 008902-008911-ET, 008912-008913-ET, 008915-008917-ET, 008918-008919-ET, 008927-008927-ET, 008931-008935-ET, SPOE00053559-SPOE00053559-ET, SPOE00053560-SPOE00053560-ET i rishikuar, SPOE00053562-SPOE00053563-ET, SPOE00053568-SPOE00053569-ET, SPOE00053574-SPOE00053575-ET, SPOE00053578-SPOE00053578-ET, SPOE00053591-SPOE00053591-ET, SPOE00053592-SPOE00053592-ET, SPOE00053593-SPOE00053594-ET i rishikuar, SPOE00053596-SPOE00053597-ET, SPOE00053600-SPOE00053602-ET, SPOE00053604-SPOE00053604-ET, SPOE00053605-SPOE00053605-ET, SPOE00053608-SPOE00053609-ET, SPOE00053611-SPOE00053613-ET, SPOE00053617-SPOE00053617-ET, SPOE00053625-SPOE00053627-ET, SPOE00053653-SPOE00053654-ET, SPOE00053662-SPOE00053665-ET, SPOE00053667-

SPOE00053667-ET, SPOE00053683-SPOE00053684-ET, SPOE00053709-SPOE00053710-ET i rishikuar, SPOE00053714-SPOE00053714-ET, SPOE00053716-SPOE00053716-ET, SPOE00053721-SPOE00053721-ET, SPOE00053723-SPOE00053725-ET, SPOE00053729-SPOE00053730-ET, SPOE00053732-SPOE00053733-ET, SPOE00053742-SPOE00053743-ET, SPOE00053753-SPOE00053755-ET, SPOE00053768-SPOE00053768-ET, SPOE00053771-SPOE00053774-ET, SPOE00053783-SPOE00053785-ET, SPOE00053790-SPOE00053791-ET, SPOE00053796-SPOE00053797-ET, SPOE00053812-SPOE00053813-ET, SPOE00053837-SPOE00053837-ET, SPOE00053849-SPOE00053851-ET, SPOE00053852-SPOE00053853-ET i rishikuar, SPOE00053856-SPOE00053857-ET, SPOE00053861-SPOE00053861-ET, SPOE00053929-SPOE00053931-ET, SPOE00053946-SPOE00053947-ET i rishikuar, SPOE00053947-SPOE00053949-ET, SPOE00053962-SPOE00053964-ET, SPOE00053974-SPOE00053977-ET i rishikuar, SPOE00053982-SPOE00053986-ET, SPOE00053997-SPOE00053998-ET, SPOE00054012-SPOE00054013-ET, SPOE00054015-SPOE00054016-ET, SPOE00054019-SPOE00054019-ET, SPOE00054049-SPOE00054050-ET, SPOE00054064-SPOE00054065-ET i rishikuar, SPOE00054086-SPOE00054086-ET, SPOE00054134-SPOE00054134-ET, SPOE00054139-SPOE00054144-ET, SPOE00054155-SPOE00054155-ET, SPOE00054158-SPOE00054160-ET, SPOE00054204-SPOE00054207-ET, SPOE00054234-SPOE00054235-ET, SPOE00054245-SPOE00054246-ET, SPOE00054361-SPOE00054361-ET, SPOE00054377-SPOE00054377-ET, SPOE00054441-SPOE00054442-ET i rishikuar, SPOE00054507-SPOE00054508-ET, SPOE00054517-SPOE00054518-ET, SPOE00054541-SPOE00054541-ET, SPOE00054557-SPOE00054558-ET, SPOE00054593-SPOE00054594-ET, SPOE00054618-SPOE00054619-ET, SPOE00054694-SPOE00054694-ET, SPOE00054715-SPOE00054715-ET, SPOE00054756-SPOE00054756-ET i rishikuar, SPOE00054803-SPOE00054803-ET,

SPOE00054825-SPOE00054826-ET, SPOE00054829-SPOE00054829-ET, SPOE00054880-SPOE00054881-ET, SPOE00054901-SPOE00054901-ET, SPOE00054910-SPOE00054912-ET, SPOE00054919-SPOE00054919-ET, SPOE00054920-SPOE00054920-ET, SPOE00054935-SPOE00054936-ET, SPOE00054965-SPOE00054966-ET, SPOE00055007-SPOE00055007-ET, SPOE00055009-SPOE00055009-ET, SPOE00055029-SPOE00055030-ET, SPOE00055041-SPOE00055042-ET, SPOE00055043-SPOE00055044-ET, SPOE00055067-SPOE00055070-ET, SPOE00055071-SPOE00055071-ET, SPOE00055081-SPOE00055081-ET, SPOE00055085-SPOE00055085-ET, SPOE00055090-SPOE00055092-ET, SPOE00055116-SPOE00055118-ET, SPOE00055145-SPOE00055145-ET, SPOE00055146-SPOE00055147-ET, SPOE00055194-SPOE00055194-ET, SPOE00055260-SPOE00055262-ET, SPOE00055265-SPOE00055266-ET, SPOE00055270-SPOE00055271-ET, SPOE00055282-SPOE00055282-ET, SPOE00055290-SPOE00055292-ET, SPOE00055305-SPOE00055306-ET, SPOE00055319-SPOE00055319-ET, SPOE00055323-SPOE00055325-ET, SPOE00055349-SPOE00055350-ET, SPOE00055351-SPOE00055352-ET, SPOE00055385-SPOE00055385-ET, SPOE00055393-SPOE00055394-ET, SPOE00055394-SPOE00055398-ET, SPOE00055399-SPOE00055399-ET i rishikuar, SPOE00055418-SPOE00055418-ET, SPOE00055420-SPOE00055421-ET, SPOE00055427-SPOE00055427-ET, SPOE00055428-SPOE00055429-ET, SPOE00055431-SPOE00055433-ET, SPOE00055434-SPOE00055436-ET, SPOE00055462-SPOE00055462-ET, SPOE00055470-SPOE00055471-ET, SPOE00055479-SPOE00055480-ET, SPOE00055488-SPOE00055489-ET, SPOE00055516-SPOE00055517-ET, SPOE00055523-SPOE00055524-ET, SPOE00055558-SPOE00055563-ET, SPOE00055578-SPOE00055592-ET, SPOE00055594-SPOE00055597-ET, SPOE00055601-SPOE00055608-ET, SPOE00055609-SPOE00055617-ET, SPOE00055619-SPOE00055620-ET, SPOE00055620-SPOE00055620-ET, SPOE00055624-SPOE00055625-ET, SPOE00055626-

SPOE00055627-ET, SPOE00055628-SPOE00055629-ET, SPOE00055636-SPOE00055636-ET, SPOE00055674-SPOE00055674-ET, 019602-019603, 019645-019645, 019664-019664, 019741-019741, 019764-019765, 021111-021111, 019779-019780, 019784-019785, 019786-019788, 020411-020412, 020413-020413, 020644-020645, 020657-020657, 020676-020679, 020694-020695, 020754-020755, 020760-020761, 020823-020825, 020881-020882;

d) **URDHËRON** Administratoren të caktojë numra të provave materiale për materialet e pranuara;

e) **HEDH POSHTË** pranimin e atyre fotografive që janë në faqet 008172-008185 në 007789-008966, me përjashtim të fotografisë së Nezir Myrtajt që është në faqen 008176, të pranuar më lart;

f) **URDHËRON** ZPS-në të përgatisë dhe dorëzojë provën materiale të fotografisë së Nezir Myrtajt dhe mbishkrimin përkatës, siç urdhërohet në paragrafin 39, deri **të mërkurën, 30 gusht 2023, ora 16:00**; dhe

g) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë çdo kërkesë për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo materiali të pranuar deri **të mërkurën, 30 gusht 2023, ora 16:00.** Çdo përgjigje ndaj tyre duhet dorëzohet deri **të mërkurën, 6 shtator 2023, ora 16:00**. Kundërpërgjigjet nuk do të merren parasysh.

_____/nënshkrimi/____

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E martë, 8 gusht 2023

Në Hagë, Holandë.